



MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

MIDIS

ODËS SË STOMATOLOGJËVE TË KOSOVËS (OSK) DHE FAKULTETIT TË MJEKËSISË DENTARE-TIRANË (FMD)

Neni 1

Oda e Stomatologëve të Kosovës dhe Fakulteti i Mjekësisë Dentare (në vazhdim *Palët*) shprehin vullnetin dhe mirëkuptimin për një bashkëpunim të qëndrueshëm dhe të domosdoshëm për rritjen dhe përmirësimin e vazhdueshëm të performancës profesionale të stomatologëve nëpërmjet formave të ndryshme të Edukimit të Vazhdueshëm Profesional (në vazhdim *EVP*).

Neni 2

OSK dhe FMD bien dakord dhe mbështesin sistemin e krediteve të detyrueshme për stomatologët e sistemit publik dhe privat si parakusht për rilicensimin e tyre dhe ruajtjen e të drejtës për ushtrimin e profesionit.

Neni 3

OSK merr angazhimin për të njohur dhe për të akredituar format e ndryshme të aktiviteteve në kuadër të EVP e që FMD organizon dhe është bartës i tyre. FMD bashkëpunon dhe mbështet OSK për gjetjen e formave më efektive dhe më të mundshme të EVP, në përputhje me kërkesat dhe nevojat konkrete të stomatologëve.

Neni 4

Palët dakordohen për shkëmbimin e pedagogëve për mbajtjen e ligjeratave në kuadër të aktiviteteve të EVP.

Neni 5

Palët inkurajojnë vizitat bilaterale/multilaterale duke përfshirë ftesat për ngjarjet më të rëndësishme në fushat e ndryshme të stomatologjisë. Shpenzimet e udhëtimit dhe të qëndrimit do të jenë në bazë të reciprocitetit.

Neni 6

Ky memorandum lidhen në afat të pacaktuar. *Palët* mund të bien dakord në çdo kohë për përfundimin e këtij memorandum.

Neni 7

Çdo mosmarrëveshje lidhur me interpretimin ose zbatimin e këtij memorandum zgjidhet me mirëkuptim mes *Palëve*.

Neni 8

Ky memorandum është lidhur në gjuhën shqipe dhe atë në 2 (dy) ekzemplar identik, nga 1 (një) për secilën palë dhe hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të tij.

Tiranë, 12.02.2021

Për Odën e Stomatologëve të Kosovës

Për Fakultetin e Mjekësisë Dentare

Prof. Dr. Blerim Kamberi

Prof. Asoc. Edit Xhajanka

Kryetar i OSK-së

Dekane e FMD

